

AKT-THEMELIMI
I
SHOQERISE TREGTARE "Kejdi Solar" SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar , sot **ne daten 26/04/2022** behet themelimi i shoqerise "**Kejdi Solar**" SH.P.K me seli ne **ELBASAN Lagija Shenkoll, zk.8522, pasuria nr.14/232** nga ortaku i kesaj Shoqerie **Z.Kejdi Qosja i dta 23/09/1999**, i pajisur me karte identiteti me numer personal **J90923080J**

VENDOSIN

Te krijojne nje Shoqeri Tregtare te emertuar "**Kejdi Solar**" SH.P.K me kushtet e meposhtme:

NENI 1

Themeluesi ne cilesine e ortakut krijojn shoqerine tregtare "**Kejdi Solar**" SH.P.K me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "**Kejdi Solar**" SH.P.K emery qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj.
Ajo ka vulen e saj ne te cilën eshte shkruar "**Kejdi Solar**", SH.P.K, Elbasan, Albania.

NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne:

ELBASAN Lagjja Shenkoll, zk.8522, pasuria nr.14/232



Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jetë i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj.

NENI 6

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :

Tregtim, instalim dhe mirembajtje impiante fotovoltaike dhe cdo produkti tjeter ne lidhje me kete sektor, import-eksport, dhe shitja me shumice e pakice e tyre,..etj. Ofrimin e shërbimeve të konsulencës inxhinierike elektrike me specifikë teknologjinë fotovoltaike, duke përfshirë por pa u limituar në: Import-eksport dhe tregtim të pajisjeve, makinerive, materialeve ose sistemeve të prodhimit dhe konservimit të energjisë elektrike nga teknologjia e fotovoltaikëve dhe teknologjia e pajisjeve që i shërbejnë asaj, përfshirë por pa u limituar në: pajisje elektrike, elektronike ose elektromekanike që përmbajnë teknologji fotovoltaike, module fotovoltaike, invertera fuqie (invertera diellorë), kontrollorë karikimi, pajisje montimi të sistemeve fotovoltaike përfshirë sistemet ndjekës, bateri, kabëll solar, pajisje mbrojtëse, aksesorë, elektropompa fotovoltaike, matësa me dy drejtime (bidireksionale) dhe sisteme të monitorimit në distancë ose grumbullimit të të dhënave nga sistemevet fotovoltaike, përfshirë edhe software. Zhvillimin, Projektimin, Studimin e Fizibilitetit. Hartimin e projekteve elektrike fotovoltaike. Vizatimet inxhinierike dhe specifikime teknike për impiante fotovoltaike , për impiante kogjeneruese që përfshijnë teknologjinë fotovoltaike, për sisteme fotovoltaike te lidhur ne rrjet,dhe autonom si dhe ato Hibride në objekte rezidenciale, tregtare, institucionale, terrene dhe në çdo objekt tjeter për të cilin do të arrihet mareveshja. Sigurimin e shërbimeve të implementimit, ndërtimit, kolaudimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së impianteve (ose centraleve FV) të impianteve kogjeneruese që përmbajnë teknologjinë fotovoltaike dhe, të çdo sistemi ose pajisjeje tjeter që përmban teknologjinë fotovoltaike. Ofrimin e shërbimeve të optimizimit të sistemeve FV, të projektimit dhe implementimit të zgjerimit të sistemeve FV ekzistuese, të integrimit të sistemeve që përmbajnë



teknologjinë fotovoltaike, të monitorimit të sistemeve fotovoltaike. Kryerjen e punimeve civile në funksion të ndërtimit të impianteve FV të lartpërmendura. Kryerjen e testimeve, shërbimeve të matjeve të natyrës elektrike dhe matjeve meteorologjike në funksion të projektimit dhe monitorimit të sistemeve FV. Ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të çdo projekti që përfshin teknologjinë fotovoltaike. Objekt i kësaj Shoqërie do të jetë dhe çdo veprimtari tjeter ligjore tregtare lidhur me sa më lart, konform legjisacionit në fuqi. Implementimin dhe zbatimin e projekteve per eficencen energjitike konform legjisacionit ne fuqi.

Dhe cdo aktiviteti tjeter te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjisacionit Shqipetar.

NENI 7

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **100.000** (njeqindmije) leke shqiptare.
Ortaku Z.Kejdi Qosja **zoteron nje kuote me vlere 100.000 leke ose 100 % te kapitalit themeltar.**

NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte perjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjisacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga asambleja e ortakeve dhe administratori. Themeluesit me vendim te vecante do te emerojne dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijoje fondin rezerve.



Fitimi neto qe do te rezultoje ne fund te cdo viti finanziar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakeve.

NENI 11

Percaktimi i struktureve organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te asamblese se ortakeve. Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Kejdi Qosja, i dtl 23/09/1999**, lindur ne Elbasan e banues ne Elbasan, i pajisur me karte identiteti me numer personal **J90923080J**

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

NENI 12

Regullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

**“Kejdi Solar” SH.P.K.
Kejdi Qosja**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Kejdi Qosja".